



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KUÇOVË

Lënda : Analiza e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kuçovë për periudhën Janar – Qershor 2016.

Në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2 , datë 06. 02. 2012,“ Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, si dhe Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 15/01/2016, të Ministrisë së Financave; “ Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2016, më poshtë po japim një përmbledhje të ecurisë së zbatimit të buxhetit të vitit 2016 për Bashkinë Kuçovë dhe institucionet në varësi për periudhën: Janar – Qershor.

Drejtoria e Financës e organizon punën e saj sipas ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, “ Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Duke filluar nga muaji Janar e në vazhdim është punuar për zbatimin me korrektësi të V.K.Bashkiak Kuçovë nr. 06 dt. 31.01.2016 “Për Buxhetin e Bashkisë Kuçovë për vitin 2016” të konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 167/1 dt 10.02.2016 “ Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kuçovë për vitin 2016”.

-Të ardhurat e Bashkisë për periudhën Janar- Qershor 2016:

Në lekë

PERIUDHA	Plani vjetor	Plani 6-mujor	Fakti 6-mujor
JANAR – QERSHOR VITI 2016	201,200,000	100,600,000	55,099,509

Planifikimi për 6 mujorin është 100,600 mijë lekë, fakti është 55,099,509 lekë, realizimi për 6- mujorin është 54.77%.

Ne zbatim të ligjit nr. 9632 date 30/10/2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar analizojme realizimin e të ardhurave të Bashkisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, duke u ndalur në faktoret kryesore që kanë ndikuar në realizimin dhe mosrealizimin e disa treguesve dhe në miremenaxhimin e arketimit të Taksave dhe Tarifave vendore për këtë periudhë.

Me poshtë do të analizojme realizimin e të ardhurave nga burimet e veta të Bashkisë, si Taksat Vendore të popullatës ( Pastrim, Ndricim dhe Gjelberim ), tatimin dhe qerata e tokës, të ardhurat nga ndertimet dhe legalizimet, si edhe nga Taksat e Tarifat e tjera, të planifikuara për vitin 2016.

Për realizimin e detyrave të kësaj periudhë, administrata e bashkisë është angazhuar për të bërë maksimumin e mundshëm për mirë administrimin e vjeljes dhe realizimit të të ardhurave.

Për realizimin e detyrave nga Tatimet, Taksat dhe Tarifat Vendore, për gjashtëmujorin 2016 është punuar në drejtim të rritjes së bazës së taksueshme, të arketimit të të ardhurave për çdo takse dhe tarife, të luftes kundër informalitetit, të përmirësimit të komunikimit të vazhdueshëm me taksapaguesit, si dhe të zbatimit të procedurave ligjore.

Pavaresisht nga puna e bërë, administrata e bashkisë duhet të kishte punuar më shumë dhe me efektivitet me të lartë, pasi për periudhën që po analizojmë rezultojnë se të ardhurat për gjashtëmujorin 2016 në total kanë plotësuar këta tregues: Në 000 leke.

Plani	107 303	leke
Fakti	54 981	leke
Diferenca	52 322	leke
%	51	%

Sipas njesive administrative, të ardhurat janë realizuar si më poshtë: Në 000 leke.

	Plani	Fakti	Diferenca	%
Kuçovë	56 903	40 402	-16 501	71
Kozare	19 351	5 717	-13 633	30
Perondi	17 720	6 558	-11 161	37
Lumas	13 330	2 303	-11 026	17
<b>Shuma</b>	<b>107 303</b>	<b>54 981</b>	<b>-52 322</b>	<b>51</b>

Të dhënat e mësipërme tregojnë se për gjashtëmujorin 2016, më mirë me realizimin e planit të të ardhurave paraqitet njësia administrative Kucovë me 71 % dhe më keq paraqitet njësia administrative Lumas me 17 %.

Më poshtë po analizojmë treguesit e realizimit të të ardhurave për gjashtëmujorin 2016 sipas zerave në mënyrë analitike :

**TAKSA E NDËRTESESË**

Per arketimin e kesaj takse eshte punuar ne bashkepunim edhe me agjentin tatimor, Ndermarrjen e Ujesjellesit, duke bere te mundur qe te ardhurat per gjashtemujorin 2016 te realizohen ne masen 8 938 000 leke, nga 14 277 000 leke te programuara, pra me pak 5 339 000 lek, ose 63 %

Sipas njesive administrative tregusit jane si me poshte ne 000 leke.

	Plan	Fakt	Diferenca	%
Kuçova	9 775	6 040	-3 735	62
Kozare	1 665	1 030	- 635	62
Perondi	2 042	1 450	- 592	71
Lumas	795	419	- 376	53
<b>Shuma</b>	<b>14 277</b>	<b>8 938</b>	<b>-5 339</b>	<b>63</b>

Sipas struktures se tatimpaguesve kemi keto te dhena ne 000 / leke :

	Plani	Fakti	Diferenca	%
Biznesi i madh	2 180	956	- 1 224	44
Biznesi i vogel	7 400	3 981	- 3 419	54
Nderm/Instituc	690	818	+ 128	119
Popullata	4 000	285	- 3 715	7
<b>Totali :</b>	<b>14 277</b>	<b>8 938</b>	<b>- 5 339</b>	<b>63</b>

Te dhenat e tabelave te mesiperme tregojne se perqindjen me te larte te realizimit e kane ndermarjet dhe institucionet, e cila ka ardhur si rezultat i arketimit te detyrimit te vitit te meparshem gjate gjashtemujorit 2016, kurse perqindjen me te vogel te realizimit per kete periudhe me 7 % e ka popullata. e cila vjen nga mosderdhja e detyrimeve nga popullata si rezultat i faktoreve social dhe ekonomik, por edhe te nje pune me efektivitet me te larte qe duhej te ishte nga administrata e bashkise dhe nga agjenti tatimor i perzgjedhur per te mbledhur kete takse.

### TAKSA E RREGJISTRIMIT TË MJETEVE

Per gjashtemujorin 2016 te ardhurat nga kjo takse e cila arketohet nga Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit Rrugor Berat jane realizuar ne masen 3 906 000 leke, kundrejt 3 600 000 leke te programuara ose 108 %, ose 306 000 leke me shume.

### TAKSAT DHE TË ARDHURAT NGA URBANISTIKA

Te ardhurat nga Drejtoria e Urbanistikes per periudhen e gjashtemujorit 2016 jane realizuar sipas zerave te meposhtem: Ne 000 leke

	Plani	Fakti	Diferenca	%	Taksa e ndikimit ne Infrastr	3 000
864 - 2 136 29	Legalizime			12 000	2 047	- 9 953 17
Qera Apartamenti	600	215	- 385	36		
Tarife Privatizim banese	0	88	+ 88	-		
<b>Shuma</b>	<b>15 600</b>	<b>3 214</b>	<b>- 12 386</b>	<b>21</b>		

Nga te dhenat e mesiperme rezulton se ne nivelin e ulet te arketimit te ketyre te ardhurave peshen kryesore e zene te ardhurat nga taksa e legalizimeve, e cila eshte realizuar 17 %, per arsye te procedurave te legalizimit gjate kesaj periudhe nga ana e institucionit te Aluiznit Berat.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja eshte realizuar vetem 29 %, kurse te ardhurat nga qerate e apartamenteve jane realizuar 36 % gjate gjashtemujorit 2016.

### TAKSA E THERJES

Per gjashtemujorin 2016 jane arketuar nga Drejtoria e Veterinarise 88 000 leke nga Taksa e Therjes nderkohe qe programi i te ardhurave nga ky ze ka qene ne masen 140 000 leke pra 63 %, ose 52 000 leke me pak.

### TAKSA E ZENIES SE HAPESIRES PUBLIKE

Te ardhurat e realizuara nga zenia e hapesires publike nga bizneset per gjashtemujorin 2016 jane 1 168 000 leke nga 2 800 000 leke te programuara, ose 42 %, pra me pak nga plani 1 632 000 leke .

### LEJE TRANSPORTI DHE TARIFA E PARKIMIT

Te ardhurat nga Lejet e Transportit dhe Tarifa e Parkimit menaxhohen nga Drejtoria e Transportit dhe Drejtoria e te Ardhurave dhe per gjashtemujorin 2016 , keto te ardhura u realizuan ne masen 725 000 leke, nga 620 000 leke te programuara, pra 117 %, ose 105 000 leke me shume nga plani.

### TARIFA E TREGUT

Te ardhurat nga Tarifa e Tregut per gjashtemujorin 2016 jane realizuar me 3 331 000 leke, kundrejt 4 090 000 leke te programuara pra 759 000 leke me pak, ose 81 % .

Per kete periudhe realizimi analitik eshte si me poshte:

Tregu i perqendruar u realizua 2 686 000 leke, kundrejt programit prej 3 150 000 lek ose 85 %, dhe me pak 464 000 leke, si rezultat i mosfunksionimit te te gjithë bokseve gjate gjashtemujorit 2016, si dhe i mos pageses ne afatin e percaktuar nga disa tregëtare ne tregun e perqendruar

Tregu i jashtem u realizua 645 000 lek, i cili i krahasuar me programin prej 940 000 lek, realizimi eshte 69 %, ose 295 000 leke me pak se programi, per shkak edhe te uljes se numrit te tregtareve qe tregetojne ne ambiente te pa miratuara ne zbatim te ligjit.

### TARIFA E LËNIES SË MALLIT NE TREG

Per periudhen qe ne po analizojme jane arketuar 411 000 leke kundrejt programit prej 480 000 lek ose 86 %, pra me pak 69 000 leke, dhe kjo diference argumentohet me faktoret e analizuar me siper te realizimit total te te ardhurave te tregut.

### TARIFA E PASTRIMIT

Te ardhurat nga Tarifa e Pastrimit per gjashtemujorin 2016 jane realizuar 11 560 000 leke, kur te programuara ishin 14 676 000 leke, ose me pak 3 116 000 leke, pra ne vlere relative 79 %,
   
Te ardhurat nga kjo tarife jane realizuar sipas kesaj natyre taksapaguesish , si me poshte: (000/lek)

	Plani	Fakti	Diferenca	%		
1. Nga subjekte fizike e juridik	9 080	5 907	- 3 173	65		
2. Nga ndermarjet/Institucionet	2 000	920	- 1 080	46	3. Nga popullata	3
600 2 927 - 673	81					
<b>Totali :</b>	<b>14 676</b>	<b>11 560</b>	<b>- 3 116</b>	<b>79</b>		

Te dhenat e mesiperme tregojne se ne mosrealizimin e ketyre te ardhurave, ka ndikuar me shume mos derdhja e detyrimeve te kesaj tarife nga subjektet e ndermarrjeve dhe institucioneve te cilat jane raelizuar 46 %, ku peshen kryesore e ka subjekti “Albpetrol” sh.a.

### TARIFA PËR NDRIÇIMIN RRUGOR

Te ardhurat e realizuara per gjashtemujorin 2016 nga tarifa per ndriçimin jane 3 420 000 leke, nga 3 680 000 leke te programuara ose 93 % dhe per me pak 261 000 leke.

Per njesine administrative Kuçove e cila ze peshen kryesore ne realizimin e te ardhurave nga ky ze paraqitet si me poshte:

Ne 000 leke.

	Plani	Fakti	Diferenca	%
- Biznesi	642	676	+ 34	105
- Nd/Institucion	180	132	- 48	73
- Popullata	2 383	2 079	- 304	81
- <b>Totali :</b>	<b>3 205</b>	<b>2 888</b>	<b>- 316</b>	<b>90</b>

### TARIFA E MJEDIS – GJELBERIMIT

Per periudhen e gjashtemujorin 2016, kjo tarife eshte realizuar 1 999 000 leke, nga 2 210 000 leke te programuara ose 90 %, pra me pak 211 000 leke.

Me poshte sipas struktures jane realizimet perkatese:

Ne 000 leke.

	Plani	Fakti	Diferenca	%
- Biznesi	390	482	+ 92	124
- Popullata	1 200	1 284	+ 84	107
- Nd/Institucion	620	227	- 393	37
- <b>Totali :</b>	<b>2 210</b>	<b>1 999</b>	<b>- 211</b>	<b>90</b>

Nga analiza e bere per realizimin e te ardhurave edhe nga dy tarifat e mesiperme, ne menyre analitike sipas treguesve, vihet re se faktoret qe kane ndikuar ne keto mosrealizime jane po ata qe kemi theksuar ne analizen e tarifes se pastrimit pasi jane te njejtet subjekte qe realizojne keto te ardhura.

### QERA OBJEKTI SIPERMARRJE

Gjate gjashtemujorit 2016 per kete tregues jane arketuar 215 000 leke, kur te programuara ishin 500 000 lek, ose 285 000 leke me pak, per shkak te nje vakumit ligjor per pronat, si dhe te mos arketimit te ketij detyrimi nga subjekti “Enarvi” ndaj te cilit eshte zbatuar procedura ligjore deri ne organet e drejtesise.

### TATIMI I TOKES

Per gjashtemujorin 2016 jane realizuar 2 966 000 leke nga 8 600 000 leke te programuara nga njesite administrative qe e kane kete lloj tatimi si me poshte;

Sipas njesive administrative treguesit jane : (000 leke)

	Plani	Fakti	Diferenca	%
Kozare	2 625	311	-1 954	12
Perondia	3 983	1 805	-2 178	45
Lumasi	1 992	850	-1 142	43
<b>Shuma</b>	<b>8 600</b>	<b>2 966</b>	<b>-5 634</b>	<b>34</b>

Te dhenat e mesiperme tregojne se arketimet nga kjo takse jane realizuar me pak ne njesine administrative Kozare me 12 % dhe ne total jane realizuar vetem 34 %, dhe ky tregues shtron para administrates se Bashkise

dhe ne vecanti te Njesive Administrative, detyren e angazhimit me te madh per zbatimin e ligjit ne drejtim te arketimit te ketij tatimi duke patur parasysh edhe vleren debitore te krijuar ne periudhat e meparshme.

### QERA TOKE BUJQESORE DHE PYJORE

Per gjashtemujorin 2016 te ardhurat e ketyre treguesve jane realizuar 762 000 leke, nga 4 000 000 leke te programuara pra 19 %.

Sipas njesive administrative jane keto tregues ( 000 leke).

	Plani	Fakti	Diferenca	%
Kozare	1 963	0	- 1 963	0
Perondi	1 113	338	- 775	30
Lumas	924	424	- 500	46
<b>Shuma</b>	<b>4 000</b>	<b>762</b>	<b>- 3 238</b>	<b>19</b>

### TË ARDHURA NGA KOPSHTET DHE ÇERDHE

Per periudhen e gjashtemujorin 2016 te ardhurat nga kuotat e kopshteve dhe çerdheve jane realizuar si me poshte:

Kuota cerdhesh nga 900 000 lek te programuara jane arketuar 821 000 lek ose 91 %

Kuota kopeshtesh nga 1 500 000 lek te programuara, jane arketuar ne 1 950 000 lek ose 130 %. Keto te ardhura vijne ne varesi te frekuentimit te kopshteve dhe cerdheve nga moshat parashkollore dhe te arketimit te detyrimeve debitore te periudhave te meparshme.

### TARIFA E UJIT TE PIJSHEM

Gjate gjashtemujorit 2016 per kete tregues jane arketuar ne njesine administrative Kozare, 1 679 000 leke, kur te programuara ishin 4 200 000 lek, ose 2 521 000 leke me pak, ose ne vlere relative 40 %

Nga analiza e treguesve te realizimit te te ardhurave per periudhen e gjashtemujorit te pare te vitit 2016, rezulton se treguesit me perqindjen me te ulet te realizimit, te cilet zene 93 % te vleres se mosrealizimit; jane si me poshte:

Treguesi	Vlera / 000 leke	%
- Debitoret	17 997	34
- Tarifa nga Legalizimet	9 953	19
- Tatimi i Tokes	5 634	11
- Taksa e Nderteses	5 339	10
- Tarifa e Pastrimit	3 116	6
- Tarifa e Ujit te pijshem	2 521	5
- Tarifa e Ndik. Infrastrukture	2 136	4
- Qera Toke	2 200	4

Nisur nga sa analizuam dhe relatuam me siper, objektivi yne per te ardhmen eshte eliminimi i shkaqeve dhe faktoreve qe kane çuar ne mosrealizimet e taksave dhe tarifave te gjashtemujorit 2016, dhe njekohesisht te bejme te mundur, krijimin e infrastrukture se nevojshme dhe rritjen e ndjenjes se pergjegjesise te administrates se Bashkise dhe sidomos te administrates se Njesive Administrative, per realizimin e programit te te ardhurave per vitin 2016, per te cilin puna dhe vemendja e drejtorise se te ardhurave dhe e drejtorive te tjera te Bashkise duhet te perqendrohet ne:

#### 1. Ndjekjen dhe realizimin e te ardhurave nga Taksat Vendore

Per keto :

- Per taksen e nderteses per vitin 2016 duke patur parasysh qe nuk eshte vendosur ne faturen e ujesjellesit, eshte domosdoshmeri qe te behen te gjitha perpjekjet dhe procedurat ligjore, per ta futur edhe kete takse ne faturen e ujesjellesit.

-Tarifa e pastrimit do te arketohet ne periudhen ne vazhdim pasi perbehet nga vlera debitore per te cilet jane zbatuar dhe do te zbatohen te gjitha procedurat ligjore.

#### 2.Ndjekja me pergjegjesi e arketimeve te te gjitha debitoreve te ndryshem, te cilat perbehen ne perqindjen me te madhe nga debitoret e tatimit te tokes dhe te nderteses.

Per keto:

- Jane derguar dhe po dergohen ne çdo familje Akt-Detyrimet me vlerat debitore per te gjitha vitet dhe per te gjitha tatimet

- Eshte kerkuar dhe po kerkohe nga te gjitha drejtorite qe sherbimi te kryhet pasi te jene paguar te gjitha detyrimet qe kane ndaj Bashkise, sipas parimit "Pa paguar taksat dhe detyrimet tatimore nuk do te kryhet asnje sherbim".

#### 3.Rritja e angazhimit dhe e pergjegjesise se drejtorise se urbanistikes ne bashkepunim me faktoret e tjere per te ardhurat perkatese, te cilat zene 23 % te vleres se mosrealizimit

#### 4. Ndjekjen e ecurise se regjistrimit dhe te pageses se detyrimeve te subjekteve qe kryejne aktivitet, ne bashkepunim me Policine Bashkiake, Drejtorine Tatimore Rajonale dhe QKR.

#### 5. Gjetjen e rrugeve dhe mundesive te reja, ne bashkepunim me te gjitha aktoret dhe faktoret per rritjen e te ardhurave te Bashkise dhe rritjen e sherbimeve dhe mireqenies se jeteses te te gjitha komunitetit te Bashkise se Kuçoves.

**-Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2016:**

Më poshtë jepet realizimi i shpenzimeve në periudhën Janar- Qershor 2016, krahasuar me planin vjetor për Bashkinë dhe institucionet në varësi:

**në 000 lekë**

N r	Emërtimi	Paga			Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative			Investimet			Te Tjera			
		Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %			
1	Bashkia	81233.2	33,600.3	41	13,160.2	5,574	42	32,173	6,184	19	7,242	242	3	7,455	1,022	13.707
2	Shërbimet Publike							51,813	15,467	30	51,758	21,956	42			
3	Qendra Ekonomike e Arsimit	74179.54	35,200.3	47.01	12,492.0	5,860.55	46.91	19,237	8,958.26	46.57	140	122	87	10,308	5,611	54.43
4	Qendra Kulturore	3,910.00	1,233.2	31.54	630.0	205.96	31.21	2,293.78	623	27	360	85	24			
5	Mirëmbajtje Rrugë&Trotoare	20549	8,464.3	41.19	3,448	1,411.20	40.93	33,304	11,090	33	1,070	0	50			
	<b>TOTAL BASHKIA KUÇOVË</b>	<b>179,872</b>	<b>78,177.6</b>	<b>43</b>	<b>29,760</b>	<b>13,052</b>	<b>44</b>	<b>138,821</b>	<b>42,323</b>	<b>30</b>	<b>60,570</b>	<b>22,405</b>	<b>37</b>	<b>17,813</b>	<b>6,632</b>	<b>37.234</b>

Tabela e mësipërme pasqyron faktin e shpenzimeve gjate 6-mujorit te pare te vitit 2016 kundrejt planit vjetor.

Nga tabela rezulton se në total (Bashki, Ndërmarrja Komunale, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Qendra Kulturore) fondet e veta, janë realizuar në fakt në shumën 162,588 mijë lekë ndërsa fondet e planifikuara vjetore jane në shumën 428,336 lekë, realizimi i fondeve në total është 37.96%.

Realizimi i fondeve plan – fakt, për Bashkinë Kuçovë është 33 %, për Shërbimet Publike realizimi i fondeve është 36.13%, për Qendrën Ekomonike të Arsimit 47.64%, për Qendrën Kulturore 29.73% dhe për Ndërmarrjen Komunale 35.89%.

Në nivel artikulli realizimi i fondeve në total rezulton si më poshtë:

**-Shpenzimet për paga** janë realizuar në masën 43 % të planit vjetor, po kështu edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 44 % kundrejt planit vjetor.

**-Shpenzimet operative** janë likujduar në masën 30% të planit të përgjithshëm vjetor.

**-Shpenzimet e tjera** janë realizuar në fakt 37.23%. Në këtë zë përfshihen shpenzimet e kryera për transferta që kryhen për agentë tatimorë, ndihma ekonomike për rastet e veçanta të Bashkisë, ndihmë për raste fatkeqsish, shpërbllim për dalje në pension pleqërie dhe transferta për KF Naftëtari.

Më poshtë jepet realizimi i shpenzimeve në periudhën Janar- Qershor 2016, krahasuar me planin 6 Mujor për Bashkinë dhe institucionet në varësi:

në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga	Sigurime Shoqërore			Shpenzimet operative		Investimet		F. emergjence		Te Tjera	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	i NjësiVe Vendore Bashkia	406 16. 6	33,603	6580.26	5,574	16,087	6,184	7,242		1,500	0	7,455	1,022
2	Shërbimet Publike					25,906	15,467	51,758		0	0		
3	Qendra Ekonomike e Arsimit	370 89. 77	34,875.23	6,246.0 0	5,860.55	9,619	8,958.26	140		0	0	5,611	5,611
4	Qendra Kulturore	1,9 55. 00	1,233.29	330.00	205.96	1,146.89	623	360		0	0		
5	Mirëmbajtje Rrugë& Trotuare	102 74. 5	8464.53	1,724	1,411.20	16,652	11,090	1,070		0	0	50	
	<b>TOTAL BASHKIA KUÇOVË</b>	<b>89, 936</b>	<b>78,176</b>	<b>14,880</b>	<b>13,052</b>	<b>69,410</b>	<b>42,323</b>	<b>60,570</b>		<b>1,500</b>	<b>0</b>	<b>13,116</b>	<b>6,632</b>

Nga tabela rezulton se në total fondet e veta, janë realizuar në fakt në shumën 162,588 në mijë lekë ndërsa fondet e planifikuara si 6- mujor jane në shumën 247,912 lekë, realizimi i fondeve 65.58%.

Në nivel artikulli realizimi i fondeve, rezulton si më poshtë:

-**Shpenzimet për paga** janë realizuar në masën 87 % të planit 6- mujor, po kështu edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 88 % .

-**Shpenzimet operative** janë likujduar në masën 61% të planit 6- mujor.

-**Shpenzimet e tjera** janë realizuar në fakt 50,6%.

1. **Për Bashkinë** realizimi i fondeve në nivel artikulli rezulton si më poshtë:

**Shpenzimet për paga** janë realizuar në masën rreth 83% të planit 6-mujor ose rreth 41% e planit të përgjithshëm vjetor, po kështu edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë me një realizim; 42 % e planit vjetor, ndërsa kundrejt planifikimit per 6- Mujorin e I-rë 2016 janë realizuar në masën 85% të planit. Mosrealizimi në këtë zë shpenzimesh vjen për shkak të vendeve të punës që kanë qënë vakante.

-**Shpenzimet operative** janë likujduar në masën 19% të planit të përgjithshëm vjetor dhe 38% te planifikimit per 6 Mujorin e pare. Shpenzimet operative në total janë realizuar 6,183,826 lekë.

Në këtë zë përfshihen shpenzimet operative të kryera për funksionimin e aparatit, si:

- Shpenzime për shërbime nga të tretë ( ujë, energji elektrike, telefon-internet) realizuar në vlerën 549,381 lekë.

- Shpenzime për karburant, realizuar në vlerën 1,582,647 lekë, nga të cilat 720,780 lekë karburant janë shpenzuar nga Drejtoria e Zhvillimit Rural për mirëmbajtjen e kanaleve vaditëse e kulluese në Njësitë Administrative, 200,004 lekë janë shpenzuar për karburant nga sektori për Mbrojtjen nga Zjarri, 420,828 lekë për karburant janë shpenzuar për administratën e Policine Bashkiake dhe 241,035 lekë shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.

- Shpenzime për pagesat e anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe Kryepelqtë në vlerën 3,161,154 lekë, shpenzime gjyqësore në vlerën 40,800 lekë, shpenzime të cilat shkojnë për përmbaruesin gjyqësor që do të kryejë vjeljen e gjobave të vendosura nga Inspektoriati i Ndërtimit.

-Shpenzime për uniforma Policia Bashkiake në vlerën 204,000 lekë.

-Shpenzime për kancelari e materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës likujduar në vlerën 145,466 lekë.

Diferenca janë shpenzime për materiale pastrimi e shpenzime të tjera administrative.

Shpenzimet operative të mësipërme përfshijnë shpenzimet e kryera për Bashkinë, PMNZSH dhe Njësitë Administrative. Pra siç shihet shpenzimet administrative janë minimale, edhe pse ka patur kërkesa për materiale nuk janë kryer, për shkak të mungesës së fondeve në dispozicion. Janë blerë vetëm kancelari e tonera për të mos penguar funksionimin e punës në institucion.

-**Investimet** në total janë likujduar në masën 42% të planit të çelur kjo vjen për shkak të lidhjes së kontratave me vonesë dhe jo për mungesë likuiditeti.

Gjate 6 Mujorit të parë të vitit 2016, investimet e planifikuara me **fondet e veta** ishin: 1,500,000 lekë për blerje pajisje zyre, nga të cilat:

- 242,000 lekë për blerje kompjuterash, planifikuar dhe prokuruar gjate vitit 2015 dhe likujduar gjate 6 mujorit te pare te vitit 2016.

Pjesa tjetër janë investime janë të kryera nga ish komunat të parashikuara në buxhet, (nga të cilat gjatë muajit Korrik 2016 janë likujduar 1,046,000 lekë Plani i Përgjithshëm Vendor Perondi dhe 228,000 lekë supervizim punimesh).

Pjesa tjetër e detyrimeve të prapambetura e të palikujduara vjen për shkak se ka mungesa në dokumentacion: mungesë faturash, numra llogarish, kontaktesh me kontraktorët, mungesë procedurash.

-Investimet e financuara nga **Grant i Kushtëzuar** gjate 6 Mujorit të parë të vitit 2016 janë:

- 996,000 lekë për blerje automjeti ( mjet pune ) , i planifikuar dhe prokuruar gjate vitit 2015 dhe likujduar gjatë 6 mujorit te parë vitit 2016. Ky automjet është transferuar pranë Ndërmarrjes Komunale.

- Rikonstruksion i KUZ në lagjen 1 Maji Kuçovë: Kontrata për këtë objekt është lidhur më dt. 28.12.2015, me vlerë 18.928.476 lekë me tvsh. Deri tani është likujduar në vlerën 7.000.000 lekë, aq sa fondi i çelur. Me shkresë zyrtare kemi kërkuar çeljen e fondit për pjesën e mbetur, për të bërë të mundur likujdimin total të detyrimit kundrejt kontratës së lidhur për këtë objekt.

- Rikonstruksion i rrugës Kristaq Laçka – Qemal Stafa, kontrata për këtë investim u lidh më dt. 27.05.2015 me vlerë 140,043,456 lekë, punimet u kryen gjatë vitit 2015 dhe 2016. Të gjitha detyrimet për punimet e kryera në 2015 u likujduan brenda vitit. Për vitin 2016 diferenca e kontratës ishte planifikuar në vlerën 13,601,910 lekë, investimi ka përfunduar dhe është likujduar plotësisht në vlerën 13,599,709 lekë.

Kolaudim i rrugës Kristaq Laçka – Qemal Stafa, planifikuar dhe likujduar në vlerën 360,000 lekë.

Eshtë lidhur kontrata për tenderin “për Rehabilitimin e Sistemit të Ujitjes dhe Kullimit” në dy Njësitë Administrative Kozare dhe Perondi, planifikuar në buxhet në vlerën 29,600,000 lekë, kontrata është lidhur më dt. 22.06.2016 me vlerë 29,475,457 lekë, punimet janë në proces (gjatë muajit Korrik janë likujduar për punime të kryera 7,662,024 lekë dhe gjatë muajit Gusht 11,676,906 lekë, nuk ka fatura të palikujduara).

Është lidhur kontrata e shërbimit të konsulencës mbi “ studime projektimi për rikonstruksionin dhe rehabilitimin e rrugës Kuçovë - Urë Vajgurore” më dt.08.08.2016 me vlerë të plotë 6,235,200 lekë nga 7,000,000 lekë të planifikuara në buxhet.

Ka përfunduar tenderi për furnizimin me karburant për administratën, Policinë Bashkiake, MNZSH dhe për mirëmbajtjen e sistemit të Ujitjes e Kullimit dhe furnizimi vijon normalisht.

Ka përfunduar prokurimi dhe është lidhur kontrata për Rikonstruksionin e shkallëve tek “Pika Turistike” dhe është lidhur kontrata më dt.02.08.2016 me vlerë të plotë 9,105,600 lekë..

Është në process tenderimi rikonstruksioni i rrugës “ Kongresi i Lushnjës”.

Nga investimet e planifikuara në buxhetin e vitit 2016 deri tani ka mbetur pa u prokuruar “ Rikonstruksion i oborrit të shkollës...”, rikonstruksion zyrash” për dhe blerje automjeti për Bashkinë Kuçovë.

**-Shpenzimet e tjera** ( në këtë zë janë parashikuar shpenzime për transferta tek institucione, transferta tek individë, fondi rezervë dhe fondi i emergjencës).

Realizimi është 846,239 lekë i ndarë si vijon: ndihmë ekonomike për rastet e veçanta është realizuar 571,239 lekë dhe 275,000 lekë ndihmë ekonomike për raste fatkeqsie. Pagesat e ndihmës ekonomike për rastet e veçanta janë kryer menjëherë pas miratimit në buxhet. Nuk ka detyrime të palikujduara në këtë zë të buxhetit.

-Transferta tek institucione janë realizuar si vijon:

\* Transferta për Ujësjellësin Kuçovë ( 2.5% e të ardhurës së arkëtuar nga ky agjent tatimor) është realizuar në vlerën 126,775 lekë.

\* Transferta për Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat është realizuar në vlerën 48,819 lekë.

**- Shërbimet Publike:**

- **Shërbimi i pastrimit** i është likujduar 14,820,699 lekë, në lidhje me këtë shërbim rezultojnë detyrime të mbartura nga viti 2015, të cilat edhe pse janë të parashikuara ne buxhet nuk mund t'i likujdojmë për shkak se janë

të pafirmosura e vulosura nga personat përgjegjës në ish komunën Perondi. Për periudhën Janar – Mars 2016 detyrimet e palikujduara për shërbimin e pastrimit janë në vlerën 1,817,826 lekë, këto detyrime nuk janë shlyer për mungesë të ardhurash.

- **Shërbimi i Dekorit:** për këtë shërbim, shpenzimet janë likujduar në vlerën 420,652 lekë, detyrimet e palikujduara për 6-mujorin e parë janë në vlerën 157,640 lekë.

- Në lidhje me shërbimin e **Mirëmbajtjes së Varrezave Publike**, kontrata e lidhur për këtë shërbim mban datën 11.05.2016, shërbimi ka filluar me lidhjen e kontratës, shpenzimet e kryera dhe likujduara për 6-mujorin e parë janë 225,992 lekë.

Faturat e palikujduara për shpenzime të kryera për periudhën Janar –Qershor 2016 në total janë në vlerën 3,202,115 lekë ( shpenzime për shërbimin e pastrimit, dekorit, pajisje zyre, materiale elektrike, blerje pajisje zyre etj.)

-**Ndihma ekonomike që financohet nga buxheti i shtetit** për 6 mujorin e parë të vitit 2016, planifikuar 11,998,000 është realizuar në vlerën 10,407,261 lekë.

- **Pagesa e Paaftësisë që financohet nga buxheti i shtetit** për 6 mujorin e parë të vitit 2016 planifikuar 97,064,000 lekë, është realizuar në vlerën 91,591,887 lekë.

2. **Për Qendrën Ekonomike të Arsimit:** realizimi i fondit të pagave është 94% e planit 6 mujor, fondi i sigurimeve shoqërore rezulton i realizuar 94%, shpenzimet operative kundrejt planit 6 mujor janë realizuar në masën 93.14%, Investime 87%, transfertat 100% e planit gjashtë mujor.

Në zërin **të tjera**, vlera prej 5,610,065 lekë, përbëhet nga transfertat që kanë shkuar për financimin e Shoqërisë anonime “Klubi i Futbollit Naftëtari” e cila financohet tërësisht nga buxheti i Bashkisë Kuçovë dhe pagesa për shpërblim për dalje në pension pleqërie.

Në mënyrë të përmblodhur planifikimi dhe realizimi i fondeve është si vijon:

Nr	Emërtimi i Njësive Vendore	Paga		Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative		Investimet		Te Tjera	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pl 6 muj	Qendra Ekonomike e Arsimit	37089.77	34,875.23	6,246.00	5,860.55	9,619	8,958.26	140	122	5,611	5,611
Pl. Vjetor	Qendra Ekonomike e Arsimit	74179.54	34,875.23	12,492	5,860.55	19,237	8,958.26	140	122	10,308	5,611

Realizimi i shpenzimeve operative:

-1. Nga ana e QEA janë likujduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve në zërat ujë, energji, telefon , duke lënë vetëm një faturë të pashlyer.

Kjo faturë që i përket shkollës Goraj, ishte me harxhim mujor 3249 kwh. Nga inspektimi i bërë nga ana e Q.E.A ky detyrim u konsiderua si mbifaturim, për këtë arsye është bërë ankimim pranë OSHEE Berat dhe Kuçovë.

-Vlera e shpenzimit të energjisë sipas faturave 6 Mujori i Parë 2016: 1 700 685 lekë

-Vlera e shpenzimit të ujit sipas faturave 6 Mujori i Parë 2016: 1 175 436 leke.

-Vlera e shpenzimit të telefonit sipas faturave 6 Mujori i parë 2016: 28 264 leke.

-2. Nga ana e QEA janë likujduar të gjitha faturat e shtesave të kontratave në zërat ushqime për fëmijët në kopështe e çerdhe, detergjente, karburant dhe shërbime për ngrohje si më poshtë:

-Vlera totale shpenzimit për furnizim me mallra ushqimore 6/Mujori I-rë; 2 238 438 lekë.

-Vlera totale e shpenzimit për furnizim me detergjenteve 6/Mujor I; 198 240 lekë.

-Vlera totale e shpenzimit për furnizim me shërbimeve për ngrohje 6/mujori I; 1 265 093 lekë.

Nga këto, dru zjarri: 960 000 lekë.

-Vlera totale e shpenzimit për karburant - 6 mujori i parë 2016 është 921 390 lekë.

Së treti, nuk janë likujduar faturat sipas zbatimit të kontratave për zërat ushqime për fëmijet dhe detergjente në vlerën 1 345 365 lekë, ndërsa në zërat karburant dhe shërbime për ngrohje është shlyer në kohë detyrimi.

Më poshtë po pasqyrojmë detyrimet e pashlyera për periudhën Janar –Qershor:

-Vlera totale e detyrimit të pa shlyer për mallra ushqimore: 991 365 lekë, Vlera totale e detyrimit të pashlyer për detergjente: 354 000 lekë.

Së katërti, janë likujduar për periudhën Janar-Qershor 2016 detyrimet e realizuara për blerje kancelarie.

- Vlera totale e shpenzimit për kancelari: 265 525 lekë



- Vlera totale e shpenzimeve për materiale pastrimi: 485 760 lekë.

Përsa i përket aktiviteteve sportive e kulturore, theksojmë se në 6/mujorin e parë shpenzimi i realizuar është:

- Për koncertet: Festa e Vitit të Ri , 7 - 8 Marsit, 5 Maj, Festa e 1 Qershorit nga Q.K.F, sipas kontratës për realizimin e këtyre koncerteve likujdimi është në vlerën 131 450 lekë.
- Kampionati Ekipor i Bilardos.Vlera e shpenzimit për dieta: 89 460 lekë.
- Dieta për aktivitete në Sportet Marciale: 46 680 lekë.
- Aktivitete sporti Volejboli, honorare: 22 780 lekë.
- Aktivitete sporti Volejboli, dieta: 100 880 lekë.

Është kryer transfertat për K.F.Naftëtari sh.a nga në vlerën 5,500,000 lekë, realizuar 55 % ndaj planit vjetor të Buxhetit.

Përveç shpenzimeve të mësipërme, për nevojat e institucioneve të varësisë janë kryer edhe shpenzime për paisje zyre dhe pune si më poshtë:

- Blerje kompjuteri në vlerën 75 000 lekë për sektorin ekonomik.
- Makine korrëse bari në vlerën 47 400 lekë për mirëmbajtjen e stadiumit.

Mund të themi se ka patur një funksionim normal të punës në të gjithë sektorët që mbulon QEA. Ky institucion ka një realizim prej 94,41% kundrejt planit 6- mujor. Ka patur furnizim normal me ushqime, materiale pastrimi e materiale të tjera për kopshtet e çerdhet, me kancelari për shkollat, në përputhje si me nevojat ashtu edhe me shpenzimet e planifikuara në buxhetin vjetor.

### 3.Për Drejtorinë e Shërbimeve Komunale, buxheti i planifikuar dhe realizuar paraqitet në tabelën në vijim:

Në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga		Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative	Investimet		Te Tjera	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt		Fakt	Plan	Fakt	Plan
	<b>i Njësive Vendore</b>									
Pl 6 muj	Mirëmbajtje Rrugë&Trotuare	10274.5	8464.53	1,724	1,411.2		11,090	268		50
Pl. Vjetor	Mirëmbajtje Rrugë&Trotuare	20,549	8464.53	3,448	1,411.2		11,090	1,070		50

Ky institucion ka përgjegjesinë për mirëmbajtjen e objekteve administrative, shkollore, kopshteve, çerdheve, rrjetit të ndriçimit, rrjetit hidraulik, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit rrugor, mirëmbajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, mirëmbajtjen e rrugëve e trotuareve etj.

1. Fondi i Pagave është realizuar rreth 87% të planit 6 mujor dhe 43 % të planit vjetor, po në këto shifra rezultojnë edhe sigurimet shoqërore rreth 88% të planit 6 mujor dhe 44 % të planit vjetor, shpenzimet operative janë realizuar rreth 67% të planit 6 mujor dhe 33 % të planit vjetor.

2.Shpenzimet operative; të planifikuara për 6-mujorin e parë rezultojnë 16,652 mijë lekë, realizimi i fondeve është në vlerën 11,090 mijë leke ose 67 % e buxhetit të planifikuar për 6- mujorin e parë.

Peshën specifike më të madhe të shpenzimeve operative të kryera e zënë shpenzimet për energjinë e ndriçimit rrugor në vlerën 8,986,829 lekë.

- Shpenzimet për mirëmbajtje të zakonshme të objekteve shkollore e administrative janë realizuar në vlerën 389,879 lekë.

-Shpenzimet për materiale për mirëmbajtjen e rrugëve e trotuareve realizuar në vlerën 546,980 lekë.

Shpenzime per karburant dhe vaj realizuar 144,979 leke dhe shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit 12,000 lekë.

Shpenzime për plehra kimike 153,600 lekë, për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra.

Shpenzime per ujë 56,688 leke.

Shpenzime për telefon dhe internet 30,670 leke.

Realizimi i buxhetit për Ndërmarrjen komunale, në total është 74,42% kundrejt planit 6-mujor.

Miratimi me vonesë i buxhetit dhe afatet e procedurave të prokurimit kanë shkaktuar vonesa në furnizimin normal të kësaj njësie në muajt e parë të vitit. Më konkretisht treguesit e buxhetit për këtë Njësi Shpenzuese janë si vijon:

Në zërin **Mirembajtje rruge-trotuare janë kryer këto punime:**

Vendosje tube Φ 300 dhe pergatitje pusete ne lagjen 1 Maji tek sheshi.

Riparim trotuari dhe shkalle ne lagjen 1 Maji rruga Q. Stafa.

Vendosje tube Φ 300 prane shkolles K. Korçari per largimin e ujerave te bardha.

Shtrese betoni për përmirësim të ambienteve të punës per punetoret e ndermarjes.

Vendosje kapak pusete ne lagjen 1 Maji prane gabines elektrike.

Skarifikim, hapje kanali, mbushje me stabilizant, vendosje tubosh Φ 500 mbrapa nenstacionit elektrik.

Skarifikim, mbushje me stabilizant prane shkolles private Reiola.

Shtrim rruge me stabilizant ne lagjen 11 Janari prane tregut.

Skarifikim, shtrim rruge me stabilizant ne rrugen mbrapa PMNZSH.

Mirembajtje e vendstrehimeve si dhe dezinfektimi në bodrumet e pallateve, ne lagjen 11 Shkurti dhe 1 Maji.

Sistemim, mbushje me stabilizant ne kodrat e perpunimit mbrapa katermase.

Shtrim rruge me stabilizant ne Nj.A.Perondi ne lagjen e Hajdereve.

Vendosje tubosh Ø 500 ne Nj.A.Kozare ne fshatin Zdrave per sistemimin e ujerave te shiut.

Shtrim rruge me stabilizant ne Nj.a.Lumas ne fshatin Krrekez.

Shtrim rruge me stabilizant ne Lagjen 11 Janari "Pusi i Gazit"

Shtrese betoni ne lagjen 1 Maji prane pallatit 5 katesh.

Izolim tarrace me llaç – çimento, lyerje e godines, punime hidraulike prane Nenprefektures.

Shtrese betoni ne sheshin e shkollës K. Korçari si dhe krijim ambienti sportiv prane saj.

Shtrim rruge me stabilizant ne lagjen 11 Shkurti nga burimi deri tek shkallet e spitalit.

Shtrim pllaka trotuari ne bulevardin e lagjes T. Skendo si dhe përgatitje e vendosje kapak pusete.

Riparim rruge me brez betoni ne Nj.A. Kozare ne fshatin Salce per pengimin e ujerave te shiut.

Ndertimi i shkalleve te reja ne fund te shkalleve ekzistuese te spitalit.

Riparim i murit te gurit si dhe brez betoni mbrapa sheshit te Kombinati.

Shtrese betoni prane pallatit 5 katesh per largimin e ujerave te bardha, prane kendit te lojerave.

Hapje kanali per vendosjen e shtyllave te ndriçimit ne parkun mbi Bashkine.

Shtrese betoni prane pallatit te UMN ne fund te lagjes 1 Maji.

Skarifikim dhe mbushje me stabilizant ne Nj.A. Kozare ne lagjen e Demollareve, Vlashuk.

Shtrim me stabilizant ne rrugen K.Koleci.

Skarifikim si dhe heqje e rrenjeve te pemeve ne lagjen Ll.Prifti prane pallatit te Kinezeve.

Pastrim dhe hapje stabilizanti prane Stadiumit.

Skarifikim dhe hapje rruge ne Fermë Partizani.

#### **Pastrim dhe mirëmbajtje kanale ujitëse dhe kulluese:**

Pastrim i kanaleve vaditese ne Nj.A.Perondi.

Jane kryer punime ne rrugen Gege – Frasher per hapjen e dherave qe kane dale nga shkarja e tarracave.

Jane hapur kanale kulluese ne Havaleas, si dhe janë bërë pastrime te disa kolektoreve kryesore kullimi.

Ne fshatin Velagosht eshte bere hapja e kanalit dhe vendosja e tumbinove ne rrugen kryesore.

Ne bashkepunim me bordin e kullimit jane bere punime ne uren me tumbino ne Lumas e cila u demtua gjate permbytjeve.

Riparim muri guri ne NJ.A.Lumas per sistemimin e kanalit vadites.

Pastrim kanali ne Lagjen 11 Janari prane Pusit te Gazit.

Hapje kanali prane varrezave te Kuçoves.

Skarifikim rruge ne Postbllok dhe ne lagjen 11 Janari.

#### ***Per mirembajtjen e objekteve administrative dhe arsimore jane kryer keto punime:***

Lyerje me boje plastike ne ambientet e QKF.

Lyerje me boje hidromat si dhe punime hidraulike ne shkollen e Vlashukut.

Lyerje me boje plastike si dhe sherbetim me gelqere ne shkollen K.Korçari.

Sherbetim dhe bojatisje me gelqere si dhe lyerje me boje vaji ne shkollen Goraj.

Ndertim bordure ne shkollen 18 Tetori.

Ne Çerdhen numer 2 eshte bere riparimi i pjeseshem i suvasë.

Ne shkollen fillore ne fshatin Ferras eshte bere lyerje me gelqere dhe riparime me stuko.

Ne shkollen Zdrave eshte bere lyerje me boje plastike dhe hidromat.

Ne shkollen Deshmoret e Kombit eshte bere lyerje me boje vaji si dhe vendosje xhamash.

Ne kopeshtin nr.1 jane bere riparime me stuko dhe fino.

Ne kopeshtin Tapi eshte bere sherbetim dhe bojatisje ne te gjitha ambientet.

Ne shkollen Tapi eshte bere lyerja e brezave te mureve te koridorit si dhe riparime hidraulike.

Ne kopeshtin 1 Qershori eshte bere lyerja komplet e ambienteve te brendshme.

#### ***Per sektorin e gjelberimit jane kryer keto punime.***

Kositja e barit ne gjithe siperfaqet dhe hapësirave midis pallateve ( rreth 10 ha)

Kositje bari neper shkolla, kopeshte dhe çerdhe, si dhe ujitja e luleve te bulevardit, ujitja e ligustrave ne hyrje te qytetit, ujitja e pemeve ne gjithe qytetin.

Punimi dhe pleherimi i pemeve si dhe trajtimi fitosanitar kunder demtueseve dhe semundjeve.

Ne shkolla dhe institucione jane bere mbjellje te pemeve dhe shkurreve dekorative.

Jane pastruar disa akse rrugore kryesore nga barerat ne Njesine Administrative Kozare.

Eshte pergatitur toka dhe farishtja per mbjelljen e luleve sezonale.

#### ***Per sa i perket sektorit te ndriçimit rrugor jane kryer keto punime:***

Ka vazhduar zëvendësimi i llampave, starteve, droselave dhe kondesatoreve të dëmtuara në pjesët më problematike të qytetit.

Jane bere kontrole te vazhdueshme vizuale linjash te ndriçimit te ndara sipas lagjeve me qellim evidentimin e defekteve, llampave te demtuara dhe marrjen e masave per riparimin e tyre.

Jane eliminuar defekte te ndryshme elektrike ne shkolla, kopeshte, çerdhe dhe ne njesite administrative. Ne çerdhen nr.1 u be zevendesimi i kuadrit elektrik dhe disa linjave te brendshme.

Jane bere punime dhe eliminime defektesh te ndryshme ne rrjetin e ndriçimit rrugor. Kur ka qene e nevojshme eshte perdorur makina me vinç.

U moren masa per kompletimin me priza, çelasa, llampa per zyrat e reja te Nenprefektura.

Eshte bere sistemimi dhe ngritja e linjes ajrore te ndriçimit rrugor ne Tapi dhe te Kodra e Perpunimit pasi paraqisnin rrezik per shkak te lartesisë se ulet.

Jane marre masa per mbarevajtjen dhe sigurimin e energjise per aktivitetet e organizuara ne qytet nga Qendra Kulturore.

Jane marre parasysh te gjitha ankesat e qytetareve per mungese te ndriçimit rrugor ne disa pjese te qytetit dhe me ardhjen e materialeve po vazhdon normalizimi i situates duke iu pergjigjur ankesave te ardhura.

Jane matur vijueshmerite elektrike te konturit te tokezimit ne shkolla, çerdhe dhe ne linjat e ndriçimit rrugor. Ne disa raste eshte nderhyre ne konturin e tokezimit ne disa çerdhe duke vendosur pilota tokezimi. Per secilin rast jane mbajtur procesverbale.

Eshte punuar per perfshirjen e kokave te ndriçimit rrugor qe nuk maten ne linjat e ndriçimit me kontrate te rregullt.

Jane zevendesuar kokat e ndriçimit dekorative te demtuara te parku dhe jane kompletuar me llampa ekonomike. Po punohet per vendosjen e 7 shtyllave te reja ndriçimi te Parku qendror.

Jane mbajtur kontakte te vazhdueshme me firmen Albstar me qellim parandalimin e defekteve te mundshme si pasoje e punimeve qe kjo firme ben prane linjave tona tokesore te ndriçimit rrugor. Ne disa raste eshte demtuar prej tyre kabli i furnizimit me energji te ketyre linjave por ne bashkepunim me Albstar kabli eshte riparuar.

Aktualisht për mungesë likuiditeti, rezultojnë detyrime të palikujduara në vlerën: 1,261,480 lekë, nga të cilat 662,080 lekë për shpenzime mirëmbajtje rruge, rrjete e elektrike, 188,000 lekë për pjesë këmbimi automjetesh, 187,000 lekë për blerje materiale hidro-sanitare dhe 224,400 lekë për blerje materialeve e vegla pune.

Moslikujdimi i detyrimeve, sjell vështirësi në furnizimin normal sipas kontratave të lidhura, gjë që bëhet pengesë në funksionimin normal të punës në këtë ndërmarje.

#### 4. Për Qendrën Kulturore, në mënyrë të përmbledhur planifikimi dhe realizimi i fondeve është si vijon:

Në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Paga		Sigurime Shoqërore		Shpenzimet operative		Investimet	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pl. Vjetor	Qendra Kulturore	3,910	1233.29	660	205.96	2,294	623	360	85
Pl. 6-mujor	Qendra Kulturore	1,955	1233.29	330	205.96	628	623	85	85

Për Qendrën Kulturore, realizimi i fondit të pagave është 63% , sigurimeve shoqërore rezultojnë i realizuar 63%, kundrejt planit 6- mujor, shpenzimet operative janë realizuar në masën 100 % e planit 6-mujor, investimet janë realizuar 24% kundrejt planit vjetor dhe 100% kundrejt planit 6 mujor. Mosrealizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore vjen për shkak të vendeve vacant pranë këtij institucioni dhe se pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e Qendrës Rinore janë likujduar nga Bashkia deri në momentin e miratimit të buxhetit për vitin 2016.

Peshën më të madhe të shpenzimeve operative e zënë aktivitetet kulturore, të cilat janë kryer sipas planifikimit në buxhet.

Shpenzimet për aktivitetet kulturore të likujduara në vlerën 492,500 lekë. Për periudhën Janar – Qershor 2016 Qendra Kulturore “Feniks” ka realizuar aktivitetet e planifikuar si më poshtë:

-“Dita e Verës”;

Ky aktivitet u zhvillua më 14 mars. Skena u ndërtua te shkallët e muzeut. Përmbajtja ishte e larmishme duke patur si synim argëtimin e gjithë grupmohave. E veçanta e këtij viti ishte pjesëmarrja e disa akrobatëve dhe animatorëve nga Cirku Kombëtar i Tiranës dhe një band muzikore e cila performoi live. Elementët e tabanit popullor u përfaqësuan nga disa këngëtarë dhe një grup fëmijësh vallëtarë. Shërbimi tregtar ofroi produktet që janë emblema e kësaj feste.

-“Ditë të filmit spanjoll”;

Aktiviteti 3 ditor u zhvillua në kinema “Kadri Roshi”. Për komunitetin hyrja ishte pa pagesë. Tre netë me radhë publiku pjesëmarrës pati kënaqësinë të shikonte disa nga realizimet më të suksesshme të kinematografisë spanjolle. Në hollin e kinemasë u çel një ekspozitë me zhvillimet ekonomike dhe kulturore të Spanjës, materiale të cilat iu dhuruan bibliotekës publike të qytetit.

-“ Ekspozitë pikturë”;

Ekspozita u çel në mjediset e bibliotekës. Kjo ishte ekspozitë bashkëautoresh e cila qëndroi e hapur për 4 ditë. Pjesëmarrja e vizitorëve ishte mjaft e kënaqshme.

-“ Dita Botërore e Letërsisë për Fëmijë ”

-“ Dita Botërore e Letërsisë dhe e të Drejtës së Autorit ”

-“ Takim me shkrimtarin “;

Këto aktivitete letrare janë zhvilluar në mjediset e bibliotekës. Boshti kryesor i këtyre aktiviteteve ishin: promovime librash, konkurset letrare, diskutime rreth veprës së autorëve të ndryshëm, biseda me autorë të ftuar, prezantim i titujve të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës.

Shpenzime të tjera si ujë, telefon, internet, abonim shtypi etj. në shumën 130,760 lekë.

Nuk ka detyrime të palikujduara për Qendrën Kulturore.

Në përfundim mund të themi se pjesa më e madhe e shpenzimeve të kryera ka shkuar për Shërbimet Publike, Qendrën Ekonomike të Arsimit dhe Ndërmarjen Komunale. Pjesa e shpenzimeve administrative si për Bashkinë ashtu edhe për institucionet e Ndërmarje në varësi është minimale, që do të thotë se fondet në dispozicion janë përdorur me efektivitet dhe bazuar në prioritetet dhe objektivat e Buxhetit për vitin 2016.

Shkak për mos likuidimin e shpenzimeve të kryera ka qënë pamjaftueshmëria e fondeve si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave të planifikuara, të cilat nuk janë realizuar në nivele të kënaqshme.

BASHKIA KUÇOVË

